

VENDIM
Nr.515, datë 19.7.2006

**PËR RISTRUKTURIMIN E INSTITUTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, NË
VARËSI TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT**

*(ndryshuar me VKM nr. 163, datë 21.3.2007; nr. 382, datë 20.6.2007; nr. 401, datë 3.5.2017; nr. 732,
datë 16.11.2022)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, 13 e 14 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar, të neneve 21, 27 e 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, dhe të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit të Arsimit e Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkriren e:
 - Institutit të Kërkimeve të Bimëve të Arave, Fushë-Krujë, (IKBA);
 - Institutit të Perime-Patateve, Tiranë, (IPP);
 - Institutit të Pemtariisë, Vlorë, (IP);
 - Institutit të Kërkimeve Zooteknike, Tiranë, (IKZ);
 - Institutit të Misrit, Shkodër, (IM);
 - Institutit të Studimit të Tokave (IST);
2. Krijimin e pesë qendrave, mbi bazën e shkrirjes së instituteve të përmendura në pikën 1, si më poshtë vijon:
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë;
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnjë;
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë;
 - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër.
3. Detyrat kryesore të QTTB-ve përfshijnë:
 - identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen, në praktikën bujqësore, të metodave dhe materialeve (imputeve) të reja për vendin;
 - përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e kafshëve;
 - kërkime dhe teste në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatëse;
 - prodhimin e hallkave të larta të disa lloje farërash dhe fidanësh të certifikuar;
 - trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjera të interesuara;
 - sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët;
 - demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë;
 - përgatitjen dhe publikimin e materialeve divulgative për specialistët e bujqësisë dhe fermerët;
 - mbështetjen me të dhëna politikëbërjeje nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural.

Drejtimit e veçanta të veprimtarisë së çdo QTTB-je, sipas kulturave bujqësore dhe kategorive të kafshëve, përcaktohen në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Stacioni i Pentarisë, Tiranë, aktualisht, pjesë e Institutit të Pentarisë, Vlorë, kalon në administrim e varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Universitetit Bujqësor, Tiranë).

5. Stacioni i Duhanit, Cërrik, aktualisht, në varësi të Institutit të Kërkimit të Bimëve të Arave, kalon në administrim e varësi të Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve (AKDC).

Detyrat kryesore të tij janë:

a) *Kërkimi në nivel ferme, për problemet e ngritura nga kultivuesit e duhanit, dhe demonstrimi i teknologjive të reja të kultivimit;*

b) *Trajnimi i fermerëve, specialistëve të bujqësisë, që përfshihen në strukturat e bashkive, në drejtoritë e bujqësisë, dhe i subjekteve të tjera të interesuara në zonat kultivuese të duhanit;*

c) *Sigurimi i ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët.*

6. Shërbimi i kontrollit të plehrave në IST të përfshihet në strukturën e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), duke funksionuar si inspektorat.

7. Shkriren e:

-Institutit të Kërkimeve Veterinare, Tiranë, (IKV);

-Institutit të Kërkimeve të Ushqimit, Tiranë, (IKU).

8. *Shfuqizohet.*

9. Instituti i Mbrojtjes së Bimëve, Durrës, (IMB) transferohet në administrim e varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Universitetit Bujqësor, Tiranë).

10. Banka Gjenetike, në Entin Shtetëror të Farërave e Fidanëve, kalon në administrim e varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Universitetit Bujqësor, Tiranë).

11. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të tokës bujqësore, trojeve, godinave e objekteve të tjera të ndërtuara mbi to, si dhe kalimin me transferim kapital të pasurisë tjetër shtetërore (të luajtshme), nga institutet ekzistuese në institucionet respektive, sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kalimet të bëhen duke iu referuar bilancit kontabël në datën e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim.

Dorëzimi dhe marrja në dorëzim të bëhen nga një komision i përbashkët, i ngritur nga dy institucionet përkatëse.

Me të njëjtën procedurë të dorëzohen edhe arkivat shkencore, financiare, materialet gjenetike, si dhe çdo dokumentacion tjetër arkivor.

12. QTTB-të dhe ISUV-ja janë institucione në varësi të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të financuara nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhurat e veta.

13. Struktura dhe numri i punonjësve të QTTB-ve dhe ISUV-së Tiranë, miratohen nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

13/1 Buxheti i Shtetit përballon shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore vetëm për numrin e punonjësve, të miratuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e numrit të punonjësve buxhetorë. Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të diferencës së numrit, të miratuar sipas pikës 13 të këtij vendimi, dhe këtij numri për punonjësit me kontratë, përballohen nga të ardhurat e tyre. Për vitin 2006, numri i punonjësve, që përballohen nga Buxheti i Shtetit, të jetë 200 veta.

13/2. *Për arsye të karakterit sezonal të krijimit të të ardhurave në QTTB-të dhe në Stacionin e Duhanit, Cërrik, pagat e punonjësve me kontratë dhe shpenzimet operative, të domosdoshme për krijimin e të ardhurave të planifikuara, në gjashtëmujorin e parë të vitit, të përballohen nga Buxheti i Shtetit. Shuma e përdorur për këtë qëllim të rikthehet në Buxhetin e Shtetit, pas krijimit të të ardhurave, brenda vitit buxhetor.*

13/3. *Përfshihet për vitin 2007, gjendja e llogarive likuiduese të ish-instituteve kërkimore-shkencore, të trajtohet si e ardhur jashtë limitit dhe të përdoret për shpenzime operative. Kjo shumë të rikthehet në Buxhetin e Shtetit pas krijimit të të ardhurave, brenda vitit buxhetor.*

14. Të ardhurat e krijuara nga QTTB-të dhe ISUV-së, përdoren në përputhje me vendimin nr.432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të

ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

14/1. Të ardhurat e krijuara nga ish-Instituti i Kërkimeve Veterinare, Tiranë (IKV) për periudhën 1995-2006, në shumën 96 000 000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë) lekë dhe të ngrira në llogari bankare, të investohen për përmirësimin e infrastrukturës laboratorike dhe për transferimin e Institutit të Kërkimeve të Ushqimit, Tiranë (IKU) në mjediset e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Tiranë (ISUV).

15. Rishpërndarja e fondeve ndërmjet institucioneve buxhetore, që preken nga ky ristrukturim, të bëhet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Punonjësit e Bankës Gjenetike, të Stacionit të Pemtarisë, Tiranë dhe të IMB-së, Durrës, me buxhetin përkatës, që nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, deri më datë 31.12.2006, të kalojnë nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (Universitetin Bujqësor Tiranë). Ky kalim bëhet në përputhje me organikën e re që do të miratohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

16. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, pas miratimit nga Ministria e Financave, të bëjë rishpërndarjen e fondeve të miratuara brenda buxhetit të saj, për vitin 2006, në përputhje me strukturën dhe numrin e punonjësve buxhetorë, të miratuar pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

17. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t'i shtohet fondi prej 8 000 000 (tetë milionë) lekësh, për të përballuar kostot e zhvendosjes së bazës materiale, për arsye të ristrukturimit dhe përshtatjen e mjediseve laboratorike.

18. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

18/1 Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t'i shtohet fondi prej 6 milionë lekësh, për shpenzimet e administrimit, të ruajtjes e realizimit të procesit të privatizimit të pasurisë së Bazës Eksperimentale, Selitë, dhe të Stacionit të Gjedbit, si dhe për zhvendosjen e serës së fidanëve perimore, prej 370 m2.

Efektet financiare të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

19. Vendimet nr.29, datë 9.2.1971, nr. 199, datë 13.5.1980; nr.86, datë 18.6.1969; nr. 549, datë 29.12.1992, nr.388, datë 3.9.1992; nr.428, datë 24.9.1995 dhe nr.197, datë 18.3.1996 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

20. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1

I. Drejtimit specifike të veprimtarisë së Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, sipas kulturave bujqësore dhe kategorive të kafshëve të jenë si më poshtë:

I/a. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë

- Kulturat foragjere, fasule, gjedhi, derrat, shpendët dhe menaxhimi i integruar i fermës;
- Shërbimet për tokën dhe ujin;
- Nevoja dhe prioritete të tjera të rajonit.

I/b Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnjë

- Perimet në sera dhe fushë të hapur;
- Gruri;
- Nevoja dhe prioritete të tjera të rajonit.

I/c Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë

- Pemët frutore bërthamore, ulliri, vreshtat, agrumet;

-Nevoja dhe prioritete të tjera të rajonit.

I/d Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Korçë

-Blegtoaria e imët;

-Pemët frutore farore, patatja, elbi;

-Nevoja dhe prioritete të tjera të rajonit.

I/e Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër

-Misri;

-Nevoja dhe prioritete të tjera të rajonit.

SHTOJCA 2

Kalimi i përgjegjësisë së administrimit për pronat e paluajtshme dhe me transferim kapital i pasurisë tjetër shtetërore (të luajtshme)

1. Nga Instituti i Perime dhe Patateve, Tiranë:

Trojet dhe objektet e tjera, të ndërtuara mbi to, i kalojnë Këshillit të Ministrave. Baza Eksperimentale, Selitë, zona kadastrale nr.8220, me pasuritë: 8/5; 8/6; 8/7; 8/9; 8/11; 8/13 dhe 8/16, të administrohet nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të kalojë në proces privatizimi.

Pasuria tjetër shtetërore i kalon QTTB, Lushnjë.

2. Nga Instituti i Kërkimit të Bimëve të Arave, Fushë-Krujë:

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë QTTB, Fushë-Krujë.

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore e Stacionit Eksperimental, Korçë i kalojnë QTTB, Korçë.

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore e Stacionit Eksperimental, Lushnjë i kalojnë QTTB, Lushnjë.

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore e Stacionit Eksperimental, Cërrik i kalojnë Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve (AKDC).

3. Nga Instituti i Pemëtarisë, Vlorë

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë QTTB, Vlorë.

Pasuria shtetërore e Stacionit të Pemëtarisë, Tiranë (përfshirë serën dhe koleksionin e pemëve frutore) i kalon MASH (Universiteti Bujqësor, Tiranë).

4. Nga Instituti i Kërkimeve Zooteknike, Tiranë:

Trojet dhe objektet e tjera, të ndërtuara mbi to, i kalojnë Ministrisë së Drejtësisë.

Pasuria tjetër shtetërore i kalon QTTB, Fushë-Krujë.

Privatizohet baza materiale e aktivitetit prodhues të Stacionit të Gjedit, sipas një vendimi të Këshillit të Ministrave të veçantë.

Pajisjet për kontrollin e materialit biologjik të Stacionit të Gjedit i kalojnë QTTB, Fushë-Krujë.

Trojet dhe objektet e tjera, të ndërtuara mbi to, të Stacionit të Gjedit, zona kadastrale nr.8310, me pasuritë: 6/16; 6/462 e 6/463, të administrohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të kalojnë në proces privatizimi.

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore e Stacionit të Bagëtive të Imta, Korçë i kalojnë QTTB, Korçë.

5. Nga Instituti i Misrit, Shkodër:

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë QTTB, Shkodër.

6. Nga Instituti i Studimit të Tokave, Tiranë:

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë QTTB Fushë-Krujë.

7. Nga Instituti i Kërkimeve Veterinare dhe Instituti i Kërkimeve të Ushqimit:

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Tiranë.

Trualli, godina dhe pasuria tjetër shtetërore e Kantinës së Prodhimit të Verës në IKU i kalojnë MASH (Universiteti Bujqësor, Tiranë).

8. Nga Instituti i Mbrojtjes së Bimëve, Durrës:

Toka bujqësore, trojet dhe objektet e tjera të ndërtuara mbi to dhe pasuria tjetër shtetërore i kalojnë MASH (Universiteti Bujqësor, Tiranë).

9. Nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve:

Pasuria shtetërore e Bankës Gjenetike në Entin Shtetëror të Farërave e Fidanëve, i kalon Mash (Universiteti Bujqësor, Tiranë).